

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Berisha në dy kohë/ Thaçi nga argat i Beogradit, në hero të Kosovës
ADRESA	https://www.cna.al/politike/berisha-ne-dy-kohe-thaci-nga-argat-i-beogradit-ne-hero-te-ko-soves-i474481
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 16:37:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 16:06:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f5827983b24aec8d90b70c7bb5025f599e3fcf3e92da72706facd60f89ed9e2b
TEKSTI	dc74bbccaa93488709c24e7ee64e7256253b95185286d977671fd8f3b8fbaeb7
PAMJA	38099e23519e87b4f00eb090d6fd4be3b940b8efd3d7218c8da0d11348376e10

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a421d13949c2dfe3d301fd349fd73444f8ea7177b0f80ecc1dd29245614d14a3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	565d15129a3a8f2c33135848c08d2b7db1d78c2d7a3d3b93f84b73cbde96b20f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a421d13949c2dfe3d301fd349fd73444f8ea7177b0f80ecc1dd29245614d14a3

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x


18:06 Politikë

Dënimi në Hagë i ish-krerëve të UÇK-së është komentuar gje...

Berisha në dy kohë/ Thaçi nga argat i Beogradit, në hero të Kosovës



17 Shtator 2026, 18:06, Politikë CNA



Dënimi në Hagë i ish-krerëve të UÇK-së është komentuar gjerësisht nga politika shqiptare, veçanërisht fati i ish-presidentit Hashim Thaçi.

Kryedemokrati Sali Berisha deklaroi në Kuvend këtë të enjte se kryeministri Edi Rama dhe presidenti serb Aleksandar Vučić janë përgjegjës direkt për vendimin ndaj Thaçit.

“Së fundi, ai Padrinoja juaj, në qoftë se ka njeri më përgjegjës direkt për atë që ndodhi në Hagë, është Aleksandër Vuçiç dhe argati i tij Edi Rama. Ku e keni tani, e keni parë të çelë ndonjë gojë, më thoni pak çfarë tha ai? Thuaj çfarë fjale ka shqiptuar? Apo ai ministri i tij? Se u zhdukën këta. Këta sjellin këtë, që ky ka imunitet të vjedhë ditë e natë dhe thotë faleminderit, më lini të vjedh më shumë”, tha Berisha.



Berisha në Kuvend: Rama dhe Vuçiç, përgjegjës direktë për dënimet e Hagës

Një ditë më parë në mbledhjen e grupit parlamentar, kryetari i Partisë Demokratike foli për vendimin e Gjykatës Speciale në Hagë duke e cilësuar atë si ‘tërësisht të pamerituar’ dhe duke shprehur mbështetjen e tij për familjet e ish-udhëheqësve politikë të Kosovës. Berisha tha se vendimi i gjykatës nuk arriti të provonte akuza konkrete.

“Gjykata e shkallës së parë në Hagë komunikoi vendime me të cilat në mënyrë absolute nuk arriti të substanciojë asgjë konkrete përveç deklaratave të përgjithshme që janë përsëritur me dhjetëra dhe qindra herë nga propaganda e Beogradit. Asgjë nuk mund të errësojë luftën çlirimtare të popullit të Kosovës që ata udhëhoqën si faqen më të ndritur të luftërave të shqiptarëve për liri dhe dinjitet kombëtar pas luftërave të Skënderbeut”, u shpreh kreu i PD-së.





Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Berisha: Vendim i pamërituar, në Beograd po festohet

Megjithatë qëndrimet e Berishës ndër vite dëshmojnë një tjetër panoramë. Në vitin 2019, kreu i opozitës lëshonte akuza të rënda ndaj Thaçit. Në emisionin "360 gradë" me gazetarin Artur Zheji, ai deklaronte:

"Hashim Thaçi është një peng i dosjes së tij të Beogradit dhe po t'i ketë ngel qoftë edhe një gramë dinjitet nuk merret kurrë me çështjen e negociatave me Kosovën pa shkuar në Hagë, pa u pastruar. Unë nuk di të ketë kryer asnjë krim. Raportin e Dik Martin unë e kam kundërshtuar po nuk e kanë kundërshtuar të tjerët që ngritën gjykatën, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Raporti është i bazuar në dosjet e Prokurorit të Beogradit. Janë 200 anëtarë dhe drejtues të LDK të ekzekutuar pas lufte. Janë 200, jo një, nga drejtues kryesorë, gazetarë e anëtarë të thjeshtë. Ky është numri i saktë. Ky duhet të shkojë atje të pastrohet, unë nuk di të ketë kryer asnjë krim, po gjykata është ngritur për raportin Dik Marti, këtë e di se kam qenë kryeministër kur është ngritur gjykata. Argati mbrapa donte ta anulonte, gjë që nuk bëhet kurrë, prandaj nuk i them unë, i thotë vetes ai që është argat. Ai nuk i tha në sy të gjithë botën Vuçiç "mbylle gojën mos fol". Nuk kam dëgjuar asnjëherë unë. Argatin e pyeti një gazetar për projektin dhe ai i tha mos fol, mbeti i shashtisur", tha Berisha.

Edhe në intervistën për emisionin "Opinion" me gazetarin Blendi Fevziu po atë vit, Berisha përsëriti akuzat e tij.

"Qëndrimi i Sali Berishës dhe Partisë Demokratike ndaj Sllobodan Millosheviçit është ky: 1-Më 22 Dhjetor Partia Demokratike ka shpallur programin "Ylli ynë polar". 2-Njohja e Republikës së Kosovës më 1991. 3-Është bërë përjekje për promovimin e lidërshiptit të Kosovës në atë kohë. 4-Në samitin e Helsinkit është futur paragraf i veçantë, në të cilin Kosova trajtohet si njësi më vete. 5-Në atë periudhë janë stërvitur në Shqipëri disa njësi të UÇK, por që të gjitha nën patronazhin e qeverisë së Kosovës, Ibrahim Rugovës. Midis tyre Adem Jashari. 6-Janë dërguar armatime falas pa asnjë çmim Bosnjes dhe Kroacisë në kundërshtim me embargon. Nëse është arrestuar Hashim Thaçi është arrestuar për krim ordiner. Hashim Thaçi flinte me një gazetar në dhomë, quhej Ali Uka, u gjet i bërë thertore në dhomë. Ai është thirrur për Ali Ukën. Nuk them fare se është i implikuar apo jo në vrasjen e tij. 7-I vetmi vend në botë që ishte kundër embargos ishte Shqipëria. Pse? Sepse rëndonte mbi Kosovën. Të tjerët ku e merrnin naftën? Naftën sipas raporteve të OKB, 96% nga Danubi. Rafineria më e madhe e Beogradit merrte me tuba nga Rumania. Ne nuk kishim mjete lundruese në liqen. Ne sollën skafet e policisë. Shkodranët e mbushnin plot serbatorin dhe kalonin me makinë dhe e shisnin në anën tjetër gjysmën e saj. Në vitin 1994 Shqipëria kaloi rezolutën në OKB me 137 vota në të cilën popullit të Kosovës i njihet e drejta për vetëvendosje. Kam bërë çmos që Prishtina të ngrihet në protesta kundër Millosheviçit. Mendoja se shqiptarët duhet të protestonin. Duhej reagim. Kaq ka qenë", tha Berisha.

Asokohe përplasja mes Berishës dhe Thaçit ishte e ashpër. Vetë Hashim Thaçi po në të njëjtën kohë, pra në 2019, ka artikulluar akuza të ngjashme ndaj kryedemokratit, duke e cilësuar argat të Millosheviçit.


"Berisha është argat i Sllobodan Millosheviçit prej 3 dekadash, bën përçarësin e politikës shqiptare, përqafton idetë antikombëtare dhe pengon të ardhmen zhvillimore të Shqipërisë. Saliu ka qenë gjithmonë që Kosova të jetë autonomi kulturore nën Serbinë. Ai ka pasur vullnetin dhe ka treguar angazhim që Kosova të mbetet nën Serbi. Sali Ramë Berisha ka furnizuar Millosheviçin me kallashnikovë që të vazhdonte gjenocidin në Kosovë", tha Thaçi.

Kjo përplasje vë në pah retorikën e liderëve shqiptarë ndaj njëri-tjetrit, një retorikë që në rastin e Berishës ka lëvizur me lehtësi nga akuzat për tradhti të solidariteti politik ndaj ish-presidentit të Kosovës. Përtej ndryshimeve të fjalimeve, historia mbetet dëshmitarja më e mirë e një hipokrizie ku kauzat kombëtare shpesh përdoren thjesht si monedhë këmbimi në tregun e vogël të pushtetit./ CNA



[View this post on Instagram](#)

A post shared by CNA.al (@cna.lajme)



Të sugjeruara

"Fundi do të jetë i dhimbshëm"/ Zhupa: Kuvendi reflekton vetëm dëshirat e Edi Ramës

"72 vota kundër një rezolute për gjenocidin serb në Kosovë"/ Muçollari: Do të mërzhiste Vuçiç

Balla-opozitës: Këtë teatrin që ju jeni atdhetarë e ne tradhtarë lëreni për një kohë tjetër

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Kuvendi i Shqipërisë deklaratë të përbashkët: Tërësisht i padrejtë

"Shko pi kafe"/ Këshilla e Berishës për ministren e Shëndetësisë

Ministrja Spahiu bën zotim: O sjell PET-Scanin deri në fillim të 2027, o jap dorëheqjen

Debatet PS-PD për vendimin e Hagës/ Ish-deputeti: Eufori për të gjetur tradhtarin, të shihen zgjidhjet

Audio-përgjimet për Ron Yeffet/ Këlliçi në Kuvend: Rama, i përfshirë drejtpërdrejt në trafikun e armëve

Berisha në Kuvend: Rama dhe Vuçiç, përgjegjës direktë për dënimet e Hagës

Rezultatet e PISA-s për arsimin/ Përplasje Boçi-Kumbaro në Kuvend

Shtyhen dy interpelanca në Kuvend/ Ja arsytet

"Doli profecia e Berishës"/ Noka, llogari Ramës: Trego pse kërkoje votimin e Gjykatës Speciale

"Rama me avion special për miratimin e Gjykatës Speciale"/ Zhupa përplaslet me socialistët: Jeni krah Vuçiç-it

"Ligji për pagat votohet sot"/ Balla ironizon opozitën: Po reflektoni për sharjet që bëni te dera e SPAK-ut

Projektligji për pagat e magistratëve/ Demokratët: U miratua një version tjetër, të shtyhet miratimi

Nis seanca plenare/ Kuvendi, me deklaratë të përbashkët për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së

VIDEO-Pas vendimit të Hagës/ Deputetët e PD-së hyjnë në Kuvend me simbole të UÇK-së

Konferenca e Kryetarëve/ PD kërkon ngritjen Komisionit Hetimor për KAYO-n, PS e rrëzon

Begaj hedh firmën/ Dekret për shkarkimin e Lamallarit, vjen ministri i ri


"Të vijojnë konsultimet me sistemin e drejtësisë"/ PD kërkon ndryshim të rendit të ditës


[editorial](#)

14:40 Editorial Elvi FUNDO

Hashim Thaçi e la Kosovën të lirë/ Erion Veliaj nuk ndahet nga karrigia që i dha PS-ja

CNA LIVESTREAM





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.